



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 21
Prishtinë, më 19.09.2012, në orën 13.00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novobërdali – kryetare, Biserka Kostiq, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Justina Pula, Albana Gashi, Kimete Bytyçi dhe Kymete Bajraktari.

Mungoi:Duda Balje

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Pjesëmarrës të tjerë: Nevahir Hajzeri-KDI, Reshit Gashi-NDI, Visar Bivolaku-EU OFFICE-EUSR, Florie Kryeziu dhe Burim Tahiri –UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novobërdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Njoftim lidhur me peticionin e parashtruar nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), lidhur me pezullimin e procesit të Privatizimit të subjekteve ekonomike PTK-së, KEK-ut dhe Trepçës;
3. Njoftim rreth projektregullores për shqyrtimin e peticioneve;
4. Të ndryshme.

Kryetarja - Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Njoftim lidhur me petitionin e parashtruar nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), lidhur me pezullimin e procesit të privatizimit të subjekteve ekonomike PTK-së, KEK-ut dhe Trepçës.

Suzana Novobërdaliu – Në pika të trasha e njoftoi Komisionin, lidhur me përmbajtjen e petitionit duke thënë: “ Jemi të informuar me këtë petition me të cilin kërkohet mbajtja e një debati parlamentar, ku do të debatohej lidhur me procesin e privatizimit të subjekteve ekonomike: PTK-së, KEK-ut dhe Trepçës”.

Kryetari i Kuvendit ka kërkuar nga ky Komision, që pas shqyrtimit t’u njoftoj Kuvendin me rekomandimet përkatëse, 62.497 nënshkrime dhe lidhur me këtë pike ajo e hapi debatin.

Kurtan Kajtazi - Meqë kryetari i Kuvendit e ka pa të arsyeshme, që ne si Komision ta shqyrtojmë këtë petition. Unë mendoj se peticioni i plotëson kushtet në bazë të Rregullores së Kuvendit për shqyrtim, por ne nuk kemi mandat të vendosim që ky proces të pezullohet apo jo. Propozoj që Kryesia së bashku me shefat e grupeve parlamentare të vendosin për debatin parlamentar dhe formën se si të organizohet ai debat, apo jo.

Rita Hajzeraj - Duke u ndërlidhur me petitionin në fjalë, tha se Peticioni është nënshkruar kundër privatizimit. Kërkesa e BSPK-së është për pezullimin e privatizimit. Këto janë dy çështje të ndara. Meqë është për pezullimin e procesit, unë jam për pezullimin e procesit. Peticioni i ka plotësuar kushtet për t’u proceduar në Kryesi të Kuvendit. Nëse Kryesia vendos të mbahet debat parlamentar, ne jemi dakord me atë se çka do të vendoset në Kryesi.

Albana Gashi - Kërkesa e sindikalistëve është një kërkesë e drejtë dhe se i përkrahi nënshkruesit e petitionit. N duhet të nxjerrim rekomandime lidhur me këtë petition.

Biserka Kostiq - Lidhur me këtë, tha se i plotëson kushtet sepse është i nënshkruar nga mbi 10 mijë nënshkrues, dhe për këtë le të vendos Kryesia.

Kymete Bajraktari- I mbështeti parafolësit lidhur me petitionin dhe tha: Peticioni i plotëson kushtet si petition dhe sugjeroj që i njëjti t’i procedohet Kryesisë së Parlamentit të Kosovës, që ajo të vendos për një debat parlamentar.

Kryetarja- Duke u ndërlidhur me diskutuesit e lartpërmendur rreth kërkesave të petitionit kërkoj që komisioni të marrë vendim lidhur me kërkesat e tyre e pastaj t’ia

procedojmë Kryesisë së Kuvendit që ajo ta radhit në agjendën e njërës nga seancat plenare.

Kurtan Kajtazi- Tha se në e shqyrtojmë petitionin se a i plotëson kushtet formale juridike si petition, është përgjegjësi e Kryesisë së Kuvendit të vendos se çka të bëhet me këtë petition, në nuk jemi kompetente të vendosim lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve apo jo, nuk është veprimtari e Komisionit kjo punë.

Justina Pula- Ishte e mendimit që të lejohet një debat parlamentar lidhur me petitionin prandaj ne, si Komision, duhet të ndjekim procedurat se si të veprojmë në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit.

Suzan Novobërdali - Pasi dëgjoi anëtarët e Komisionit, lidhur me qëndrimet e tyre rreth petitionit, rekomandoi për një debat parlamentar, duke kërkuar konkretizimin e tij, me qëllim të shqyrtimit të procesit të privatizimit apo pezullimit të privatizimit.

Pas një debati të gjërë dhe konstruktiv, që u zhvillua nga anëtarët Komisionit, lidhur me këtë pikë nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Komisioni i rekomandon Kryesisë së Kuvendit, që në pajtim me nenin 15.8, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në njërën nga seancat e radhës, ta radhisë si pikë të veçantë: Debat parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të subjekteve ekonomike të PTK – së, KEK – ut dhe të Trepçës.

3. Njoftim rreth projektregullores për shqyrtimin e peticioneve.

Suzan Novobërdali, gjërësisht e njoftoi Komisionin rreth punës që ka bërë grupi punues, për hartimin e draftregullores për shqyrtimin e peticioneve të përkrahur nga ana e NDI-së.

Në kemi ftuar përfaqësuesin e NDI-së, zotin Reshit Gashi, që për së afërmi të njoftojë Komisionin, lidhur me punën e bërë, rreth draftregullores, duke e ftuar atë që të marrë fjalën.

Reshit Gashi, NDI- Tha se ky komision ka pasur nevojë të kahmotëshme për nxjerrjen e këtij udhëzuesi, që do të ndihmojë Komisionin për shqyrtimin e peticioneve, ankesave dhe e kërkesave nga ana e subjekteve, personave fizikë dhe juridikë.

Gashi në vazhdim foli për mënyrat e shqyrtimit të peticioneve, prej momentit të procedimit të tyre në Kuvend e deri në kohën e njoftimit të palëve me përfundimet që dalin nga Komisioni.

Ky draft, do të kalojë nëpër disa faza, me ç'rast do të japim kontributin, që i njëjti të konkretizohet dhe të pasurohet nga mendimet e ofruara, si nga ekspertët, shoqëria civile dhe Komisioni, duke shtuar se të njëjtit duhet t'i bëhet një dëgjim publik dhe në muajin dhjetor 2012, të miratohet nga Komisioni.

Pas fjalës së tij, vazhdoi debati, duke kërkuar sqarim rreth draftudhëzuesit si vijon:

Kryetarija, Suzan Novobërdali, falënderoi zyrtarin e NDI-së, për punën dhe mbështetjen që po i jep Komisionit në këtë drejtim. Ajo bëri pyetje dhe kërkoj disa sqarime nga administrata se a janë të lejuara disa veprime që u përmenden më parë nga përfaqësuesi i NDI-së.

Rita Hajzeraj- Është bërë një punë e mirë në këtë drejtim, për hartimin e këtij udhëzuesi. Ideja për dëgjimin publik, është një ide shumë e mirë. Është mirë që kryetarija dhe një anëtar i Komisionit që është për shqyrtimin e peticioneve, të shkojnë dhe bisedojnë me kryetarin e Kuvendit për këtë çështje, në mënyrë që të ketë konsideratë ngase deri më tash nuk ka pasur një dokument të qartë, i cili do të përcaktojë saktë se si të bëhet shqyrtimi i këtyre peticioneve. Jam për këtë draft, sepse është për të mirën e qytetarëve.

Suzan Novobërdali - Ne kemi marrë vendim në Komision që jemi për një udhëzuesi për shqyrtimin e peticioneve.

Kymete Bajraktari- Ne të gjithë jemi dakorduar që të kemi një dokument për shqyrtimin e peticioneve. Sot nuk do të hyj në përmbajtje të këtij udhëzuesi. Këtë do ta diskutojmë njëherë tjetër. Ne e përsëritim punën e bërë deri më tani dhe le të vazhdohet puna e mëtejme ngase nuk kemi arsye t'i komplikojmë punët pa nevojë.

Justina Pula- Ne pasi ta shikojmë dhe analizojmë përmbajtjen e këtij udhëzuesi, do të shohim se çka kemi drejt dhe se çfarë hapa duhet të ndërmerim pas kësaj.

Biserka Kostiq- Sërisht para Komisionit ngriti çështjen e mospërkthimit të materialit, e sidomos të peticioneve në gjuhën e saj amtare.

Ajo, tha se nuk është hera e parë që nuk merr përgjigje rreth përmbajtjes së peticionit, por merr përgjigje vetëm për një përmbledhje të peticionit, duke kërkuar që të mos përsëritet më kjo çështje, duke kërkuar sqarim se kush është kompetent për përkthimin e materialit në gjuhën serbe, pasi që koordinatori nuk është përgjegjës për përkthime sepse nuk është kompetent për këtë.

Suzan Novobërdali - Jam interesuar personalisht, në veçanti për ankesat e Biserkës. Sa i përket këtij draftudhëzimi, sot ky duhet të përkthehet. Sot kemi pasur përkthim direkt nga përkthyesi, pasi që sot është dashur të njoftohemi me punën se çka është punuar, pa e shqyrtuar përmbajtjen e këtij dokumenti. Sa i përket peticionet, dihet që palët nuk e njohin gjuhën të gjithë dhe nuk kanë mundësi të autorizojnë përkthyes. Përkthyesit e Kuvendit, peticione nuk përkthejnë, peticione fjalë për fjalë sepse janë shumë të ngarkuar, por do të përkthehet vetëm thelbi i peticionit dhe kërkesa e peticionit. Nëse ndonjëherë kemi nevojë për më shumë, ne e kemi përkthyesin drejtpërdrejt në mbledhje dhe ai përkthen gjithçka që ne diskutojmë këtu.

Kurtan Kajtazi- Tha se është i mendimit që kryetarja e Komisionit le t'i drejtohet Kryetarit të Kuvendit me një shkresë. Le ta njoftojë me hapat që janë ndërmarrë për nxjerrjen e këtij udhëzuesi dhe domosdoshmërinë e nxjerrjes se tij. Unë propozoj që javën e parë të muajit tetor, ne si Komision, të shqyrtojmë këtë udhëzues.

4. Të ndryshme.

Albana Gashi - U interesua të dijë se a ka arritur diçka nga Gjykata Kushtetuese lidhur me kërkesën e të burgosurve për Amnisti.

Për këtë morri përgjigje se ende nuk dihet se a ka marrë vendim Gjykata Kushtetuese apo jo.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novobërdali